



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL	
Nr.Dt.No.	01 / 443
DAT.DT.	30.06.21
COUNCIL	PRISHTINË 4

KGJK.Nr.176/2021
Datë: 23 qershor 2021

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7, paragrafi 1, pika 1.14, të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Agron Hoxhaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, duke vendosur sipas Raportit të Panelit Hetimor Nr.AD/KGJK/03/2021/GJTHPZ-ADGJTHPZ.nr.02/2021, të datës 18 maj 2021, në pajtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve, nenin 19 dhe 20 të Rregullores 05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në seancën dëgjimore, të mbajtur me 23 qershor 2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

Agron Hoxhaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, **nuk** është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, pika 2.7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokuroreve.

A r s y e t i m

Paneli hetimor i themeluar me vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK.nr.109/2021, të datës 15 prill 2021, për lëndën disiplinore me numër Nr.AD/KGJK/03/2021/GJTHPZ-ADGJTHPZ.nr.02/2021, të datës 18 maj 2021, i ka paraqitur Këshillit Gjyqësor të Kosovës raportin me shkrim lidhur me hetimin e bërë për pretendime për shkelje disiplinore të kryera nga Gjyqtari i Gjykatës Themelore në Prizren Agron Hoxhaj.

Për ta shqyrtuar këtë çështje disiplinore, KGJK më datë 23 qershor 2021, ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore, ku morën pjesë Kryesuesi i Panelit Hetimor, Gjyqtari Aziz Shaqiri, dhe subjekti i hetimit, Gjyqtari Agron Hoxhaj.

Kryesuesi i Panelit Hetimor, në fillim të seancës dëgjimore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se qëndron pran raportit hetimor, duke theksuar se në bazë të fakteve dhe provave të mbledhura i mbetet KGJK-së që të shqyrtoj dhe të vendos se ka apo nuk ka bërë shkelje disiplinore Gjyqtari Agron Hoxhaj në rastin e mos përjashtimit të tij lidhur me tri lëndët përbarimore të cekura në raport.

Gjyqtari Agron Hoxhaj, në seancën dëgjimore, deklaroi se është e vërtetë që ka vendosur në lëndët përbarimore CP.nr.3221/19, CP.nr.3322/19 dhe CP.nr.3223/19, dhe palët në procedurë, respektivisht përfaqësuesit e tyre, kanë parashtruar kërkesë për përjashtimin e tij me dyshim për konflikt interesi. Më tutje, ka theksuar se bashkëshortja e tij ka ushtruar ankesë kundër të njëjtit konkurs në rrugë administrative, por e njëjta kishte aplikuar për pozitën e edukatores, e jo për pozitën e mësimit në shkollat respektive, siç kanë qenë rasti për tri palët ankuese në këtë

situatë. Në këtë situatë, lidhur me kërkesën për përjashtim ka vendosur Kryetari i Gjykatës duke refuzuar kërkesën për përjashtim si të pa bazuar. Sipas Gjyqtarit Hoxhaj me rastin e vendosjes për lëndët CP.nr.3221/19, CP.nr.3322/19 dhe CP.nr.3223/19, ai konsideron se nuk ka bërë shkelje disiplinore dhe kërkoi nga KGJK që të lirohet nga përgjegjësia disiplinore.

Për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike, KGJK administroi provat materiale siç janë: mbrojtjen e subjektit të hetimit të dhënë gjatë seancës dëgjimore e transkriptuar e datës 29.04.2021, së bashku me aktet e tjera të këtij subjekti hetimor; parashtrësën e Agjencisë Kundër Korrupsion të datës 10.03.2020 drejtuar KGJK-së për inicimin e procedurës disiplinore kundër subjektit të hetimit disiplinor lidhur me lëndët përmbartimore të propozuesve dhe në të cilin konkurs kishte marrë pjesë edhe bashkëshortja e subjektit të hetimit disiplinor, dhe që nuk ishte zgjedhur si kandidate e suksesshme; kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor e parashtruar nga U.d e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren; shkresat e lëndëve përmbartimore me numra e cekura në raport; transkripti i seancës dëgjimore të mbajtur më datë 29 prill 2021; aktvendimet e datës 17.12.2019 dhe 18.12.2019 me numra CP.nr.3221/19, CP.nr.3322/19 dhe CP.nr.3223/19 të nxjerra nga gjyqtari subjekt i hetimit Agron Hoxhaj; aktvendimi i ish Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren për refuzim të kërkesës për përjashtim të Gjyqtari Agron Hoxhaj; propozimi për përmbartim i datës 6.11.2019 i kreditores nga Prizreni e ushtruar përmes përfaqësuesit të autorizuar av. [] në bazë të vendimit të Inspektoratit të Punës në Prizren nr.110/2019 të datës 18.10.2012; aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren CP.nr.3223/19, të datës 28.11.2019; kërkesa për përjashtim e gjyqtarit Agron Hoxhaj lidhur me lëndët CP.nr.3221/19, CP.nr.3322/19 dhe CP.nr.3223/19 e parashtruar nga av. [] sipas autorizimit të Palëve; deklaratën me shkrim e Gjyqtarit Agron Hoxhaj e datës 3.12.2019 me arsyetim përkatës duke i propozuar Kryetarit të Gjykatës që ta shqyrtoj kërkesën e përfaqësuesit të tri kreditorëve për përjashtimin e tij nga tri lëndët me numra të lartcekur; Aktvendimin e IV.Gja.nr.1/2019-106 i datës 10.12.2019 i kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren me të cilën refuzohet kërkesa për përjashtim e kreditores []; Aktvendimi i GJTH në Prizren CP.nr.3223/19 i datës 18.12.2019, me të cilën refuzohet propozimi i përmbartueses [] në çështjen juridike të përmbartimit CP.nr.3223/19, për shkak të vendimit administrativ të Inspektoratit të Punës lidhur me lidhjen e kontratës për pozitën e mësimdhënëses në gjuhën shqipe në SHMU "Motrat Qiriaz" është i papranueshëm për përmbartim; ankesa e kreditores [] e datës 30.12.2019 kundër aktvendimit CP.nr.3223/19, të Gjykatës Themelore në Prizren; dhe të gjitha provat tjerat të cila i ka mbledhur Paneli Hetimor gjatë fazës së këtij hetimi disiplinor.

Pas vlerësimit të të gjitha provave një nga një dhe të gjitha së bashku, KGJK-ja vlerësoi se nuk qëndron pretendimi i Autoritetit Kompetent se Gjyqtari Agron Hoxhaj ka vepruar në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 2, pika 2.6, të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke mos raportuar përjashtimin e mundshëm siç kërkohet me Ligj, në rastin kur ka vendosur në lëndët përmbartimore CP.nr.3221/19, CP.nr.3322/19 dhe CP.nr.3223/19. Gjyqtari Hoxhaj kishte ushtruar kërkesë për përjashtim për vendosje për tri lëndët e cekura me lartë. Kërkesë për përjashtim me dyshim për konflikt interesi për tri lëndët përmbartimore kontestuese në këtë rast disiplinor kanë ushtruar edhe përfaqësuesi e tri palëve.

Më tutje, KGJK bazuar në provat dhe deklaratën e Gjyqtarit Hoxhaj, ka vlerësuar se Gjyqtari Agron Hoxhaj disa herë kishte kërkuar nga Kryetari i Gjykatës përjashtimin nga vendosja e lëndëve kontestuese. Mirëpo Kryetari me aktvendim kishte refuzuar si të pa bazuar kërkesën për përjashtim, të ushtruar nga Gjyqtari Hoxhaj si dhe nga përfaqësuesi i të tri palëve. KGJK-ja ka gjetur se kundër aktvendimit të Kryetarit të Gjykatës me të cilën është refuzuar si e pa bazuar kërkesa për përjashtim, asnjëra nga palët nuk kishte ushtruar ankesë në Gjykatën e shkallës së dytë.

Në këtë situatë, Gjyqtari Hoxhaj i kishte përfunduar tri lëndët përmbare kontestuese. KGJK-ja ka vlerësuar se Gjyqtari nuk ka kompetencë ta vetë përjashtoj vetveten, bazuar në kërkesën për përjashtim me dyshim për konflikt interesi, të parashtruar si nga palët ashtu edhe nga vetë gjyqtari,

Nga ajo që u tha me lartë, KGJK-ja vlerësoi se Gjyqtari Hoxhaj, me rastin e vendosjes në tri lëndët përmbare të lartëcekura, nuk ka bërë shkelje disiplinore të pretenduara nga Autoriteti Kompetent.

Nga se u tha me lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimi u morr njëzëri nga ana e anëtarëve të pranishëm të KGJK-së.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.Nr.176/2021, datë: 23 qershor 2021.



Qerim ADEMAJ,

Zëvendës Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Artan Serjanit, U.d Kryetar në Gjykatën Themelore në Prizren;
- Agron Hoxhaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren;
- Arkivit.